

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje **Materiale Elektrike**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale elektrike 1681410-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

8,984,333 (tete milion e nenteqind e tetedhjet e kater mije e treqind e tridhjet e tre) Leke pa TVSH,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Autoriteti Portual Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se 40% të fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësi të mallit objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohej dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, kontratën midis paleve ku të shënohet preventivi dhe vlera dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

Ose

- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përçindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi, si dhe zbatimin e kontrates pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së Autoritetit Kontraktor

3.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi kjo e vertetuar nepermjet dokumentave orgjinal si perfaqesues i kompanise prodhuese per mallin/mallrat zerat e listes

- Celat 630A 20/24 KV
- Kondicioner 12 0000 BTU
- Kamer Termike
- Treguesi i sekuencës së fazes
- Matesat Elektronik

Ne rast paraqitje Autorizimi Distributori, OE duhet të paraqesë në leter angazhim ose Akt marreveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre, mbi të drejtat e furnizimit me llojin e mallit të ofruar në Republikën e Shqipërisë.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon/fax/e-mail/website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Autorizimi i prodhuesit/shitësit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet . Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për të gjitha mallrat objekt prokurimi, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi.

Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

- i. Emri i kompanisë prodhuese ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit. Adresa dhe web-site i saktë i kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
- ii. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.

- iii. Nr.i faqes në katalogun referuar.
- iv. Nr.Idetifikues i produktit të ofruar.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

3.3 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostra për zerat:

- | | |
|-------------------------------|--------|
| • Celë630A 20/24 KV | 1 cope |
| • Kamer Termike | 1 cope |
| • Kondicioner Mural 12000 Btu | 1 cope |

Shenim: Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s’kualifikim.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar është vendosur në përputhje me piken 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe nderkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.